



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KRUJË

Nr. 226 AKTI  
Dt.16.06.2016

Nr. 226 VENDIMI  
Dt. 17.06.2016

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë e përbërë nga :

Gjyqtare: Nazmije PENGILI



Asistuar prej sekretares **Emanuela MALLKUÇI**, me pjesëmarrjen e prokurorit **Florian Bonjaku** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në seancë gjyqësore publike, sot ne date 17.06.2016, përfundoi shqyrtimin gjyqësor të çështjes penale me Nr.226 Akti në ngarkim të:

**KERKUES** : Prokuroria Rrethi Kruje perfaqesuar nga prokurori **Mirela Kapo**

**ME OBJEKT** : Vendosje Sekuestro

**Baza ligjore** : Neni 274 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet provat e marra gjate zhvillimit te gjykimit pasi degjoi prokurorin Florian Bonjaku qe kerkoj;

Vendosje sekuestro preventive mbi kaminen Grope gelqerore ne pronesi te shtetasit Edmond Xaka dhe bisedoi çeshtjen ne teresi ;

V E R E N

Se Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, sherbimet e policise gjyqesore te Komisaraiti te Policise Kruje duke u nisur nga situata problematike mjedisore mbi ndotjen e ajrit ne qytetin e Krujes,me dt.01.06.2016,ka zhvilluar kqyrjen e vendit te ngjarjes ne kaminen e gelqeres ne pronesi te shtetasit Edmond Xaka,te ndodhur ne

ekonomine pyjore Kraste-Kruje rrethi Kruje, ne afersi te firmes "San Tara" pasi eshte konstatuar prania tymrave dhe gazrave, te cilat cliroheshin nga kjo grope gelqerore. Kamina gelqerore ne pronesi te shtetasit Edmond Xaka gjate punes se saj çlironte ne menyre te pakontrolluar, sasi te konsiderueshme tymrash e gazesh ndotes. Lenda djegese e perdorur eshte tallash druri, lende drusore. Si rezultat i djegies se ketyre lendeve per prodhimin e gelqeres, rezultoi se eshte shkaktuar normativen e lejuar dhe me pasoja te demshe per shendetin e te punesuarve, banoreve perreth, si dhe duke cenuar ekuilibrat natyrore mjedisore. Mbeshtetur ne sa me siper jane kryer nje sere veprimesh hetimore si kqyrja e vendit te ngjarjes, kqyrje marrje dhe sekuestrim te provave materiale, akt ekspertimi teknik mjedisor, pyetja e nje sere personash etj. Mbeshtetur mbi materialin pocedues eshte bere edhe rregjistrimi i procedimit penal nr. 258.

Sipas akti te ekspertimit teknik mjedisore date 06.06.2016 rezulton se ;

Tejklimi i normave per permbajtjen e lendeve helmuese ne ambientet e punes eshte respektivisht.

Rezultati i matjes	norma e lejuar mg/m <sup>3</sup>	
Monoksid karboni co	7500 mg/m <sup>3</sup>	500 mg/m <sup>3</sup> .
Bioksid axoti no <sub>2</sub>	95	60
Bioksid squfuri so <sub>2</sub>	80	60
Pluhura dhe bloze	170	140

Nga sa konstatohet tejkalimi i normave per permbajtjen e lendeve helmuese ne ambientet e punes konkretisht pluhuri dhe bloza eshte nje nder agentet e pranuar nga Organizata Boterore e Shendetsise si kancerogjene. Duke ju referuar aktit te ekspertimit teknik mjedisor rezulton e provuar se vepra penale e "Ndotjes se ajrit" parashikuar nga neni 201 i K.Penal, eshte kryer per dy arsye Teknologjise primitive te prodhimit te gelqeres ne furra pa kurrfare kontrolli te kapjes se ndotesave si filtra etj. Prej perdorimit si lende djegese vec drurit dhe mbetje te tjera. Duke ju referuar kqyrjes se vendit te ngjarjes rezulton e ne vend ngjarje jane konstatuar lende drusore e industriale etj. Ne ushtrimin e aktivitetit personin nen hetim Edmond Xaka nuk eshte i pajisur me dekontacionit e duhur ligjor. Ne teresi nga sa me siper ka dyshime te bazuara ne prova dhe jo te supozuara qe personi nen hetim Edmond Xaka nepermjet perdorimit te ketyre materualeve ne kaminen gelqerore ne pronesi te tij te kete konsumuar vepren penale te "Ndotjes



se ajrit” te parashikuar nga neni 201 i K. Penal.Nga sa me siper arrihet ne konkluzion se lenia ne disponim te lire e kamines (gropes) se gelqeres se percaktuar me lart dhe lendeve djegese e materialeve te tjera te gjendura rreth saj,mund te zgjase pasojat e vepres penale dhe te rendoje me teper pasojat e saj.Keto materiale ne cdo moment mund te perdoren perseri duke risjelle te normave te ndotjes se ajrit.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 274 pika 1 e 2 të K.P.Penal,

### V E N D O S I

-Vendosjen e sekuestros preventive mbi kaminen (gropen) gelqerore ne pronesi te shtetasit Edmond Xaka dhe materialeve te tjera rreth saj te përcaktuar ne vendimin per vleftedsimin e sekuestros te provave materjale te dtes 01.06.2016

-Ekzekutimin e ketij vendimi nga forcat e Komisarariatit te Policise Kruje.

-Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda afatit ligjot.

U shpall sot ne Kruje me date 17.06.2016

**SEKRETARE**

**Emanula MALLKUÇI**



**GJYQTARE**

**Nazmije PENGILI**



Vite: \_\_\_\_\_  
Se vendim i ka \_\_\_\_\_  
ME \_\_\_\_\_  
27-06-2016  
prere \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

